

Bazë e të dhënave mbi tenderët publikë që përfituan financuesit e PDK-së

“Preportr” në një hulumtim mbi prokurimet publike ka nxjerr se 43 nga bizneset dhe personat fizik që janë pronarë biznesesh e që në dy fushatat e fundit elektorale financuan Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) të drejtuar nga Kryeministri Hashim Thaçi, kanë përfituar mbi 100 milionë euro tenderë publikë. Sipas raportit të auditimit të financave të partive **për fushatën e vitit 2009** dhe atij **për fushatën e vitit 2010**, shuma e donacioneve që këto biznese dhanë për PDK-në është veç pak më shumë se 280 mijë euro. Për 11 nga to u shkel edhe ligji dhe u dëmtua buxheti për t’i shpërblyer.

Sa dhe si përfituan bizneset që financuan fushatën e PDK-së?

Korporata “Devolli”, pronë e vëllezërve, Blerim e Shkëlqim Devolli që figuron si financues i Degës së PDK-së në Pejë me 1 mijë euro ka përfituar nga PTK-ja, me të cilën ka lidhur kontratë për operimin e kompanisë “Dardafone” si operator virtual i telefonisë mobile. Në këtë biznes milionësh PTK-ja mban vetëm 28 për qind të aksioneve, ndërsa “Dardafone” ka 72 për qind në operatorin virtual “Z-Mobile”.

Kjo kontratë, nga e cila kompania “Devolli” realizon miliona euro qarkullim është nënshkruar, pos nga ish-Kryeshefi Ekzekutiv i PTK-s, Shyqeri Haxha edhe nga Kryetari i Bordit të kësaj korporate, Rexhë Gjonbalaj, ish-Kryetar i degës së PDK-së në Pejë. Po për kontratë, Prokuroria e EULEX-it i ka ngritur një aktakuzë për pesë vepra penale ku përfshihet krim i organizuar, mashtrimi e falsifikimi me dokumente, e cila është konfirmuar nga gjyqëtarë të këtij misioni dhe në bankën e të akuzuarve për këtë punë tash janë : Shyqeri Haxha, Rexhë Gjonbalaj, Blerim e Shkëlqim Devolli si dhe Ismet Bojku.

Nga AKP-ja, “Devolli Group” duke qenë në procedurë penale, përkundër rregullave të privatizimit, privatizoi edhe dy ndërmarrje, ndërmarrjen “Amortizatorët” dhe ndërmarrjen “Emin Duraku”.

Kompania “N.N’R&Rukolli”, pronë e Rrustem Rukollit nga Skenderaj, që për PDK-në më 2009-en dha 5 mijë euro, pos tenderit prej afro 100 mijë eurosh për ndërtimin e urës mbi lumin “Drenica” në Kamaran, që e mori nga Ministria e Infrastrukturës më 20 dhjetor të këtij viti, ka një kontratë me ish-MTPT-në që peshon afro 300 mijë euro. Kjo kompani, pronari i së cilës është financues i fushatës së PDK-së, është shpallur fitues vitin e kaluar në tenderin tetë milionësh të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për ndërtimin e Fabrikës së ujit në Vushtrri. Kompania “Rukolli” është gjetur mirë edhe në tenderët e Ministrisë së Arsimit, ku ka dalë fitues në një tender për ndërtimin e objektit të shkollës në Prekaz të Skenderajt si dhe ka përfituar një sërë tenderësh nga Komuna e Skenderajt.

-Përveç tenderit prej afro 5.8 milionë eurosh që përfitoi nga ish-Ministria e Transportit dhe Postelekomunikacionit (MTPT), tash Ministria e Infrastrukturës (MI), " **AHN GROUP** " SH.P.K. pronë e Nuhi Morinës e Agim Krasniqit, që në vitin 2009 për Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) dha 2 mijë

euro, nga komuna e Malishevës në vitin 2011 ka marrë mbi 220 mijë euro për asfaltimin e rrugëve lokale në fshatin Pagarushë të kësaj komune që po ashtu udhëhiqet nga Isni Kilaj nga PDK-ja.

Po këtë vit mori edhe 160 mijë euro për asfaltimin e rrugës në fshatin Baicë të Drenasit, gjithashtu komunë e udhëhequr nga Nexhat Demaku nga PDK-ja dhe vëlla i deputetit të PDK-së, Fadil Demaku si dhe 67 mijë euro të tjera nga Komuna e Vushtrrisë, për asfaltimin e rrugës "Hamit Hyseni", institucion ky që po ashtu udhëhiqet nga PDK-ja.

"Ard Group", pronë e Avdyl Hoxhës dhe Avni Mazrekut, që në vitin 2010 dha për PDK-në si donacion një shumë prej 2 mijë eurosh, nga MTPT-ja është shpërblyer me një tender prej 8.7 milionë eurosh.

Komania "Bageri", që për pronar ka Bujar Shabanin nga Ferizaji, e që në vitin 2009 kishte dhënë 1 mijë euro donacion për PDK-në, është kontraktor i disa institucioneve që udhëheq kjo parti. Në vitin që dha donacionin për PDK-në, nga Ish-MTPT-ja "Bageri" u shpërblye me një tender prej 829 569 eurosh, për të marrë një vit më vonë nga komuna e Lipjanit, që udhëhiqet nga Shukri Buja nga PDK-ja 124 mijë euro për asfaltimin e rrugës "Haxhi Kleqka". Kjo kompani në vitin 2011, së bashku me kompaninë "Xhyli Commerce" ishte kontraktuar nga komuna e Mitrovicës, që udhëhiqet nga Avni Kastrati nga radhët e PDK-së për të asfaltuar një rrugë prej 2 kilometrash në fshatin Zhabar, ndërtimi i së cilës komunës i kushtoi 110 mijë euro.

Në po këtë vit, "Bageri" fiton nga komuna e Obiliqit tenderin prej 173 mijë eurosh për rregullimin e rrugës Mazgit – Magjistrale, dhe nga kjo komunë ishte pranuar edhe si nënkontraktor i kompanisë "Gërguri" në një punë të kësaj kompanie që peshonte 53 mijë euro.

Në komunën e Ferizajt, që udhëhiqje deri tash nga Bajrush Xhemajli, po ashtu nga radhët e PDK-së, administrata komunale kishte shkelur ligjin mbi financat publike për "Bagerin". Sipas Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) në vitin 2009, për asfaltimin e rrugës në fshatin Komogllavë, projekt që i kushtoi komunës mbi 125 mijë euro, komuna e Ferizajt kishte paguar këste në vlerë më të madhe se sa që parashihte kontrata me "Bagerin", në favor të kompanisë dhe këtë gjetje e kishte futur tek shkeljet që i klasifikoi si "rrezik i lartë".

Kjo kompani, sipas profilit të saj në internet, si pjesë të saj ka edhe bazën e prodhimit të asfaltit të komunën e Lipjanit, emri i së cilës është "Kosova Asfalt". Kjo e fundit, në një publikim të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor është futur në listën e kompanive të cilat me veprimtarinë e tyre e dëmtojnë ambientin. Në këtë publikim, "Kosova Asfalt" e kompanisë "Bageri" thuhet se ndotë ujërat nëntokësor.

Kompania "Bajraktari", pronë e Mustafë Bajraktarit, që për PDK-në në vitin 2009 dha 500 euro nga MTPT-ja një vit më vonë fitoi një tender prej 123 mijë eurosh. Në vitin që lamë pas kjo kompani fitoi një kontratë për furnizim me karburante nga Spitali regjional i Pejës me një kontratë që nuk ka vlerë fikse.

Në një kontratë të ngjashme në vitin 2010, për furnizim me derivate, për kompaninë "Bajraktari", kompani financuese e fushatës së PDK-së, ndërmarrja "Trepça" kishte shkelur Ligjin e Prokurimit Publik (LPP) disa herë. ZAP në kontratën për furnizim me derivate të naftës të nënshkruar mes

“Trepçës” e “Bajraktarit”, në vlerë prej 124,088€ ka gjetur se “Trepça” e nënshkroi kontratën duke shkelur afatet ligjore ani pse kompania në fjalë kishte mungesë të dokumentar dhe se mjetet që iu zotuan kësaj kontrate ishin bartur jashtë-ligjshëm në këtë punë nga linja e mallrave dhe shërbimeve. ZAP kishte konstatuar se për “Bajraktarin”, “Trepça” shkeli marrëveshjen për Monitorim dhe Kontroll..

Me gjithë shkeljet e ligjit që u bënë për t’ia dhënë tenderin “Bajraktarit”, kjo kompani e humbi këtë kontratë pasi që dështoi të furnizonte “Trepçën” dhe kontrata pastaj iu dha “HIB Petrolil” në vlerë prej 254,760€, apo dyfish më e lartë. Që në fillim të procedurave të tenderimit, “HIB Petrol”, në një ankesë të bërë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) kishte vlerësuar se “Bajraktari” po ofertonte për këtë tender me çmime tejet të ulëta, që nuk do të mund t’i përballonte.

Ky financues i PDK-së, ka pasur licencë për eksploatim të pasurive natyrore në “Zmiç” që nga shtatori i viti 2009 e deri në prill të vitit 2010, licencë që i ishte lëshuar nga Komisioni për Miniera dhe Minerale.

“**Bejta Comerc**”, kompani në pronësi të Basri e Adem Kçikut, e që në dy fushatat zgjedhore, atë të viti 2009 dhe vitit 2010 dha për PDK-në 1499 euro, vetëm në MTPT ka fituar kontrata në vlerë prej 7.5 milionë eurosh. Pas shndërrimit të MTPT-së në MI, “Bejta Comerc” nuk mori asnjë pjesë as në tenderin e “famshëm” të mirëmbajtjes së rrugëve. Ajo, së bashku me një sërë kompanish financuese të PDK-së, dhe jo të tilla, kishte bërë ankesë në OSHP, gjë që qoi deri në prishjen e tenderit, por as pas ri-tenderimit ajo nuk mori asgjë nga puna e mirëmbajtjes së rrugëve regjionale, tender që buxhetit të MI-së i kushtoi mbi 9 milionë euro.

Por kjo kompani këtë vit kishte marrë tenderin për asfaltimin e disa fshatrave në komunën e Kamenicës, ani pse OSHP-ja kishte konstatuar se Kamenica shkeli ligjin kur ia dha këtë tender. Kjo kompani për këtë punë, për asfaltimin e mbi 2 kilometrave asfalt e që komunës i kushtoi mbi 175 mijë euro, kishte paraqitur një plan dinamik, sipas të cilit puna do të kryhej vetëm për 6 ditë. Kompania tjetër në garë në këtë tender, “Company Zuka Comerc” kishte pretenduar që komuna e Kamenicës edhe kishte bërë ndryshime të dokumenteve nëpër dosje, që ta nxirrte fitues “Bejta Comercin”. Për shkak të këtyre shkeljeve OSHP-ja e qoi këtë tender në ri-vlerësim.

Por për këtë kompani shkeljet e ligjit vazhduan. Në korrik të vitit 2011, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), që udhëhiqet nga ministri i PDK-së, Besim Beqaj, kishte ngritur dyshimin se kryetari i bordit të ndërmarrjes regjionale të Ujësjellësit “Hidromorava” në Gjilan, Abdyl Hasani, ka konflikt të interesit. Ky konflikt ishte pikërisht për shkak të faktit se Hasani punonte edhe te “Bejta Comerc” menaxher për kualitete. Vetë Abdyl Hasani, që është i angazhuar nga komuna Gjilanit edhe në Këshillin e Ekspertëve të kësaj komune, në një letër që ia kthen MZHE-së konstaton për vete se nuk ka konflikt të interesit, ani pse “Hidromorava” ka të kontraktuar për furnizim me fraksione të zhallit kompaninë “Bejta Commerce”.

“Bejta Comerc” është kompani që është mbështetur edhe nga programi i USAID-it në Kosovë me një kredi prej 900 mijë eurosh.

“Beni Com” nga Podujeva, që për pronar ka Ismet Konushevcin, e që në dy fushatat e fundit zgjedhore dha për PDK-në 3900 euro ka marrë nga MTPT-ja, me gjashtë kontrata të ndryshme 9.4 milionë euro.

Në vitin që lamë pas, kjo kompani ishte shpallur jashtë-ligjshëm fituese e tenderit mbi 3 milionësh të Ministrisë së Infrastrukturës për ndërtimin e rrugës Kuqishtë – Bogë, por që u anulua nga OSHP-ja.

Për shkeljet që ishin bërë në këtë tender kishte publikuar hulumtime “Preportr”. Në hulumtimin me titull “Biznesi i partisë në pushtet”, me të cilën “Preportr” u shpërblye me çmimin storia më e mirë në media online për vitin 2011, bëhet me dije se kjo kompani ishte shpallur jashtë-ligjshëm fituese e këtij tenderi. Për shkeljet e ligjit që u bënë për financuesin e PDK-së në këtë tender nga MI-ja, që udhëhiqte nga Fehmi Mujota i PDK-së, u raportuan edhe nga mediat tjera.

Kjo kompani në konzorcium me “ALFA COM” morri më 2010-ën një tender nga komuna e Drenasit, komunë e PDK-së, në vlerë prej afro 29 mijë eurosh për asfaltimin e një rrugë lokale dhe nga komuna e Vushtrrisë mori edhe 9 mijë euro tjera në një tender të kuotimit të çmimit.

Në vitin 2011, për projekte të ndryshme në Vushtrri “Beni Com” morri edhe 1.2 milionë euro prokurime publike, ani pse disa nga kontratat, punët e të cilave i realizoi në vitin 2011, ishin fituar viteve të mëhershme.

“Beni Com” kishte marrë tenderë publik edhe nga komunat që nuk i udhëhiqte PDK-ja, por partia që ishte më të deri në vitin 2010 në koalicion me të, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), tash në opozitë.

Në vitin 2010 kjo kompani në konzorcium me kompaninë “CAT Company” kishte kryer punët në asfaltimin e rrugës te Lagja e Bunjakëve e fshatit Ballofc, projekt me vlerë rreth 127 mijë euro, financiar nga komuna e Podujevës, që udhëhiqet nga Agim Veliu i LDK-së. Nga kjo komunë në vitin 2007 “Beni Com”, për ndërtimin e shkollës në “Lagja e Kuvajtit” pati marrë edhe mbi 37 mijë euro.

Edhe komuna e Prishtinës që udhëhiqet nga Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa në vitin 2011 “Beni Com-in” e shpalli fitues në tenderin “Rindërtimi i rrugëve në Hajvali, Ballaban dhe Prapashticë”, tender që peshon afro 260 mijë euro.

Por ky vit, viti 2012 nuk i ka nisur mbarë “Beni Com-it”. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) e kishte shpërblyer këtë kompani, në konzorcium me kompaninë “Ndërtimtari” në tenderin për shërbimet e largimit të djerrinës, vlera e se cilit ishte 165 mijë euro. KEK, sipas OSHP-së, kishte bërë disa shkelje të LPP-së dhe tenderi shkoi në ri-vlerësim.

Kompani "Burimi" nga Malisheva, me pronar Osman Krasniqi, e që për PDK-në, në dy fushatat elektorale dha 4 mijë euro, nga MTPT-ja në vitin 2009 ishte shpërblyer me 2 tenderë vlere e të cilëve është 12.9 milionë euro. Kjo kompani në vitin 2011, sipas të gjeturave të "Preportr", është kontraktuar nga komuna e Malishevës, komunë e PDK-së, për rregullimin e trotuareve të rrugëve të fshatrave të kësaj komune dhe vlere e projektit është mbi 218 mijë euro.

"Delia Group", kompani nga Shqipëria e që aktualisht si persona të autorizuar në Kosovë ka Lekë Krasniqin e Viktor Deliajn në fushatën e vitit 2009 për PDK-në dha 500 euro, por nga MTPT-ja ë vitit 2010 mori një tender në vlerë prej 11.7 milionë eurosh. Në këtë kohë, si person të autorizuar kishte njërin nga ish-komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) për logjistikë, Haxhi Shala, i njohur si "Komandant Topi". Shala është bashkëfshatar i ish-Ministrit të MTPT-së, Fatmir Limaj, që është edhe njëri nga nënkryetarët e PDK-së.

Në një publikim të kësaj kompanie për vitin 2010, kompania e pranon që qarkullimi financiar i saj në Kosovë është pothuajse i barabartë me qarkullimin e saj në bazë, në shtetin shqiptar. Sipas të njëjti publikim, në vitin 2009, pa tenderin prej 11.7 milionësh që mori nga MTPT-ja, qarkullimi i saj financiar në Kosovë, nuk ishte as sa një e katërta e të hyrave që realizonte në Shqipëri.

N.N.P. " Engineering" me pronar Reshat Kamberin, e që për PDK-në në vitin 2009 dha 1 mijë euro nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT, që atëherë udhëhiqej nga Enver Hoxhaj i PDK-së, tash krye-diplomat i Kosovës, mori tre tenderë në vlerë mbi 1.7 milionë euro.

Kjo kompani nga komuna e Vitisë në vitin 2011 mori mbi 54 mijë euro tender për pastrimin e shtratit të lumit "Morava e Binçës", derisa një vit më herët kishte marrë nga komuna e Kamenicës, për renovimin e Sh.M."Ismail Qemali" në Kamenicë një tender prej 25 mijë eurosh.

Po për këtë kompani, komuna e Ferizajt, që udhëhiqej deri tani nga njeriu i PDK-së, Bajrush Xhemajli, kishte shkelur ligjin mbi financat publike duke derdhur në xhirrollogarinë e kompanisë më shumë para sesa që lejonte marrëveshja e kësteve në projektin për renovimin e teatrit të qytetit projekt ky që komunës i kushtoi afro 80 mijë euro. Në po këtë projekt, për të cilin ishte angazhuar N.N.P. " Engineering", punët nuk janë pranuar nga gjysma e ekipit mbikëqyrës të punimeve. ZAP këto shkelje të bëra nga Komuna e Ferizajt për N.N.P. " Engineering" i ka klasifikuar te shkeljet me rrezikshmëri të lartë.

"GRANITI " SH.P.K. me pronar Bajram Lumi nga Suhareka, e që për PDK-në dha mbi 3300 euro në vitin 2009, nga MASHT ishte shpërblyer me tre tenderë në vlerë prej 65 mijë eurosh.

Nga kjo kompani, institucione që drejtohen nga njerëz të PDK-së por edhe të partive në koalicion me ta kanë bërë një sërë blerjesh të mobileve. Kështu, Ministria e Forcës së Sigurisë, në vitin 2011 bleu 7600 euro mobile nga "Graniti", Administrata Tatimore e Kosovës 92 mijë euro, komuna e Pejës 8400 euro, Policia e Kosovës 290 mijë euro, komuna e Ferizajt 77 mijë euro, komuna e Skenderajt 3 mijë

euro, KEK-u 63 mijë euro. Në vitin 2010, komuna e Pejës kishte bërë disa herë blerje nga kjo kompani, por në vlera të vogla. Kurse në vitin 2008 kjo kompani mori edhe një tender nga KEK-u për furnizim me elektromotorë në vlerë mbi 41 mijë euro.

Edhe në faqen zyrtare të kompanisë në internet thuhet se kjo kompani ka për klientë një sërë institucionesh të qeverisë qendrore dhe ndërmarrje publike, siç është PTK-ja.

Kompania “ITK”, pronë e Ukë Muriqit, që në vitin 2009 për PDK-në pati dhënë 986 euro nga MTPT-ja ka marrë 5 tenderë në vlerë prej 1.4 milionë eurosh. Në vitin 2009 ishte pjesëmarrës, dhe u shpërblye me një llot prej 194 mijë eurosh në tenderin e sinjalistikës së rrugëve regjionale të Ministrisë së Infrastrukturës, tender rreth të cilit patën filluar përplasjet në mes Departamentit të Prokurimit në MI dhe kabinetit të ministrit Fehmi Mujota.

Sipas të dhënave në faqen zyrtare të “ITK”-së në internet, kjo kompani është pjesë e projekteve të sinjalistikës rrugore në disa komuna, pos e kontraktuar nga MI-ja. Te pjesa e klientëve në këtë faqe, pos institucioneve, “ITK”-ja ka renditur edhe “Delia Grupin”, po ashtu financues i PDK-së, kompaninë “Eurofamis”, kontraktor i Qeverisë, dhe kompaninë “Granit”.

Kompania “Getoari”, pronari i së cilës, Naim Besimi kishte dhënë për PDK-në në të dy fushatat 2300 euro, ka marrë nga MTPT-ja 3 tenderë dhe nga MASHT një të tillë, e që vlera përbashkët e tyre arrin në mbi 4.1 milionë euro.

Kësaj kompanie në vitin 2011 i dha tenderë në vlerë prej 88 mijë eurosh edhe komuna e Prizrenit dhe ishte e angazhuar për rregullimin e parkut të këtij qyteti, projekt që komunës i ishte dhënë donacion dhe kapte vlerën prej 58 mijë eurosh. Tenderi për rregullimin e ujësjellësit për pesë fshatra të regionit të Vokshit nga komuna e Deçanit iu dha në vitin 2011 “Getoarit” për 47 mijë euro.

Në vitin 2010 kishte marrë edhe një tender për ndërtimin e kanalizimit fekal dhe atmosferik në Ratkoc nga komuna e Rahovecit, vlera e të cilit ishte 470 mijë euro.

Në vitin 2009 ishte angazhuar për shtrimin e rrugës me kubëza betoni në komunën e Mamushës, projekt ky me një kosto prej 48 mijë eurosh, para që janë dhënë nga komuna e Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal (MAPL).

Edhe në vitin 2010 “Getoari” u shpërblye përsëri nga komuna e Mamushës. Tash kishte marrë tender njëburimor për ndërtimin e urës mbi lumin Toplluhane, vlera e të cilit ishte 97 mijë euro.

Ndërtimi i ujësjellësit për fshatin Gurbardh, i cili ishte donacion i AER-it, në vlerë prej 170 mijë eurove, si dhe punimet që janë kryer nga firma “Getoari”, është dashur të përfundojë më 20 qershor 2007, por për shkak të zvarritjes së fillimit të punimeve dhe në ndërtimin e tij, vetëm në vitin 201 patën përfunduar punimet e rrjetit primar.

Për "Getorain", në tenderin për ndertimin e rrugës së Xërxës, në vitin 2010, komuna e Dragashit pati bërë një sërë shkeljesh, por OSHP-ja e anuloi vendimin e kësaj komune që ta shpërblejë "Getoar" dhe këtë rast e kishte fituar "KAG Asphalt Company".

"Getoari" ishte dhe pjesë e tenderit të "famshëm" për renovimin e kullës së "Rilindjes", dhe ishte për 1 milionë euro më i lirë se kompania "Mabetex" e Behgjet Pacollit, te cilës i ishte dhënë tenderi.

Bashkë-pronarë në këtë kompani, pos Naim Besimit është edhe Omer Besimi, që është edhe pronari i vetëm i Klubit Futbollistik "Getoari" i themeluar në vitin 2003.

"Kompania Jehona" nga Malisheva e Hazir Krasniqit, që për PDK-në në vitin 2009 e 2010 dha 3500 euro donacione nga MTPT-ja mori afro 690 mijë euro në dy tenderë të ndryshëm.

Komuna e Malishevës në vitin 2010 kësaj kompanie i dha 86 mijë euro tender për asfaltimin e rrugës në fshatin Rud. Komuna e Vushtrisë, sipas ZAP-it në vitin 2008 kishte pasur telashe me një tender që i dha kësaj kompanie. "Gjatë auditimit ne kemi vërejtur se për kontratën në mes të Komunës dhe furnitorit NN Jehona Malishevë për ekzekutimin e punëve "Zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Dëshmorët e Kombit Vushtrri" e cila është investim i përbashkët me Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, garancioni/sigurimi i ekzekutimit të punëve ka skaduar më 30 Shtator 2009 ndërsa sipas datës kur ne bëmë testimin 29 Tetor 2009 puna nuk kishte përfunduar akoma.", thuhet në raportin e ZAP, ku konstatohet se Vushtrria nuk aplikoi penallti edhe përkundër vonesave të kompanisë.

Megjithëkëtë, komuna e Vushtrisë vazhdoi t'i jepte tenderë kësaj kompanie. Në listën e projekteve të realizuara gjatë vitit 2011, komuna e Vushtrisë e ka listuar "Jehona"-në në gjashtë projekte, të cilat së bashku kapin vlerën mbi 900 mijë euro.

N.T.P. " Kastrioti " me pronar Kastriot Fazlija e që për PDK-në dha 1 mijë euro donacion në vitin 2010, nga MTPT-ja ka marrë një tender prej mbi 620 mijë eurosh. Por kjo kompani ka marrë një sërë tenderësh në komunën nga vjen, komunën e Shtimes, ku pronari i saj ka marrë pjesë edhe në hartimin e strategjisë për zhvillimin ekonomik të kësaj komune.

Në vitin 2009 mori tre tenderë të ndryshëm në Shtime, vlera e të cilëve së bashku ishte 146 mijë euro. Kësaj kompani i ishte dhënë nga Komisioni për Miniera dhe Minerale një licencë për eksploatim të zhavorrit në vitin 2002 -2005. Licenca si kompani ndërtimore i ishte pezulluar për 6 muaj, që nga shtatori 2008.

Kompania "Kastrioti" është edhe hua-dhënëse e deputetit të PDK-së, Ramiz Lladrovci. Sipas deklarami të pasurisë së këtij të fundit, ai i ka borxh 90 mijë euro "Kastrioti" nga Shtimja dhe qëllimi i këtij huazimi është blerja e tokës

-Kompania "Magjistranja", me pronar Selim Pireva, e cila për PDK-në dha 2500 euro në vitin 2009, nga MTPT-ja kishte përfituar 2 tenderë publik në vlerë mbi 780 mijë euro. Nga komuna e Kaçanikut në vitin 2010 mori tenderin për asfaltimin e rrugëve lokale, kontratë prej 50 mijë eurosh dhe një kontratë për mirëmbajtjen e dimërore dhe verore të rrugëve në vlerë prej 55 mijë eurosh.. Po për asfaltim të rrugëve

lokale “Magjistranja” ishte kontraktuar edhe nga Komuna e Fushë Kosovës, tender ky që peshon 130 mijë euro.

Por, pjesën më të madhe të tenderëve kjo kompani e ka fituar në Komunën e Gjilanit, që udhëhiqet nga Qemajl Mustafa i PDK-së. Në programin e investimeve kapitale në Gjilan për vitin 2009, kjo kompani gjendet si kontraktorë i komunës në 13 projekte të ndryshme, të cilat së bashku kapin një vlerë prej 1.3 milionë eurosh.

Sipas “RAPORTI VJETOR PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE për vitin 2010 në Gjilan”, kjo komunë e kontraktoi kompaninë “Magjistranja” për 11 projekte të ndryshme, vlera e të cilave është mbi 1 milionë euro.

Edhe në vitin 2011 kjo kompani, në këtë komunë mori 6 tenderë publik në vlerë mbi 290 mijë eurosh. Edhe në këtë vit kjo komunë i ka dhënë prej 85 mijë eurosh për ” Ndërtimi i rrethrotullimit në udhëkryqin Lagja “Iliria” (rruga e Preshevës)”.

Për këtë kompani komuna e Gjilanit kishte dhënë pagesa pa kontratë, por vetëm me nënshkrim të kryetarit të saj, Qemajl Mustafa. Gjatë auditimit ne kemi vërejtur që projekti “Mirëmbajtja verore e rrugëve në Gjilan” e kompletuar nga kontraktuesi “N.N.T. Magjistranja”, në shumën totale sipas kontratës 76,716 EURO që ishte oferta me çmimin më të ulët, përderisa pagesa totale e bërë ndaj këtij kontraktuesi ishte 132, 216, EURO, duke tejkaluar shumën e kontraktuar për 55,502 EURO. Për këtë nuk është gjetur kontratë shtesë, por vetëm miratimi i kryetarit të komunës për punët shtesë për t’u pranuar nga kontraktuesi. Sipas ligjit për prokurim publik 2007/20, entiteti mund të kontraktoj punë shtesë në maksimumin prej 10% te kontratës pa pasur nevojë të publikojë tender të ri, përderisa në këtë rast entiteti ka thyer këtë rregull”, thuhet në raportin e ZAP-it për vitin 2008, ku kjo gjetje klasifikohet: “Rreziku i lartë”.

N.N.P.,Mati - Com", pronë e Brahim Kryeziut nga Bubaveci i Malishevës, që për PDK-në në vitin 2010 për PDK-në ka dhënë 1 mijë euro donacion, nga MTPT-ja ka marrë një tender në vlerë prej 284 mijë eurosh. Në vitin 2011, në tenderin është shpallur fitues nga Komuna e Malishevës, që udhëhiqte nga PDK-ja, në tenderin : RENOVIMI I KULLAVE NË FSHATRAT BANJË DHE LLAPQEVË”, që peshon 28 mijë euro.

N.T.P.,Metali" me pronar Elbasan Alidema nga Pozhorani i Vitisë ,që për PDK-në në të dy fushatat e fundit ka dhënë 2 mijë euro, nga MASHT ka fituar një tender mbi 530 mijë euro.

Në vitin 2010 kjo kompani nga komuna e Kaçanikut, që udhëhiqet nga Xhabir Zharku i PDK-së ka angazhuar si kontraktorë këtë kompani në 4 furnizime me mobile e inventar në vlerë mbi 14 mijë euro. Në vitin 2011 Gjilani i kishte dhënë tre tenderë, vlera e të cilëve së bashku arrinë në 20 mijë euro. Me Gjilanin, “Metali” kishte pasur edhe në vitin 2010 tri kontrata, vlera e të cilave është mbi 33 mijë euro së bashku.

Po, komuna e Gjilanit, komunë e PDK-së nuk e kishte lënë “Metalin” vetëm me “tenderë të vegjël”. Në vitin 2011, në tenderin : Lidhja e marrëveshjes së partneritetit publiko – privat, ku përmes bashkimit të punës dhe mjeteve dhe kapitalit do të bashkëveprohet në ndërtim, mirëmbajtje dhe menaxhim të N.P. “HIGJIENA” sh.a. Gjilan – procedurë dyfazëshe të negociuar të tenderit”, përveç “Sh.p.k. “ ECOVISION” Gjilan & “MOSER GROUP”-Austri, është kualifikuar edhe NTP “METALI”-Pozhoran.

Për këtë kompani institucionet kanë bërë edhe shkelje të ligjit. “Gjatë auditimit tonë kemi vërejtur se projekti ishte i ndarë në disa shpenzime më të vogla se EUR 10,000. Komuna ka bërë kontrata të veçanta dhe pagesa kompanisë NTP Metali gjatë vitit 2008. Ne kemi identifikuar katër pagesa të veçanta të bëra për këtë kompani në shumën prej EUR 505, EUR 6,006; EUR 3,350 dhe EUR 8,345 me një total prej EUR 18,286. Më tutje, komuna duhet të kishte botuar në gazetë tenderin, siç kërkohet me Ligjin për Prokurimin Publik dhe në këtë mënyrë do të kishte shmangur favorizimin e një furnizuesi të vetëm. Komuna nuk ka bërë publike tenderin në gazetë ashtu siç kërkohet me ligjin e prokurimit”, thuhet në raportin e ZAP për vitin 2008, për komunën e Kamenicës.

Një vit më vonë, në vitin 2009, sipas ZAP komuna e Novobërdës kishte shkelur dy herë LPP-në për “Metalin” në tenderin me furnizimin me material ngrohës: dru dhe thëngjill.

Në vitin 2010, Kompania për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave (KMDK), kishte bërë shkelje të vazhdueshme në tenderin për furnizim me makineri të rëndë, ku shpallej fitues “metali”, por ankohej financuesi tjetër i PDK-së, “Getoari” nga Prizreni. Për këtë tender, vlera e të cilit ishte afro 400 mijë euro, ishin zhvilluar disa seanca në OSHP dhe ishte raportuar edhe në media.

Pos kësaj shume, prej afro 400 mijë eurosh që i dha më 2010, KMDK-ja këtë kompani e ka shpërblyer edhe në vitin 2011 me tenderin “Furnizim me Kamion Kiper”, vlera e të cilit është 128 mijë euro.

N.N. "Ndërtimi", biznes në emër të Sabit Zabelajt, e që për PDK-në në vitin 2009-2010 dha 3500 euro, në MASHT e MTPT, në secilën prej tyre, ka marrë nga dy tenderë, vlera e të cilëve arrinë në 820 mijë euro.

Në vitin 2010 kishte marrë edhe një tenderë nga komuna e Malishevës, në vlerë prej 309 mijë eurosh për rregullimin e rrethrotullimit në fshatin Banjë, fshat nga i cili është edhe ish-Ministri i MTPT-së, Fatmir Limaj.

N.N.P. " Shkoza FO7 ", biznes në pronësi të Fidaie Bytyçit, që në vitin 2009 për PDK-në dha 1 mijë euro, nga MTPT-ja ka marrë 2 tenderë në vlerë prej mbi 800 mijë eurosh.

Për “ NDËRTIMI I RRUGËS TRANZITORE NË QYTEZËN E MALISHEVËS -FAZA E PARË”, në vitin 2010 nga Malisheva mori 275 euro, kurse një vit më vonë, në vitin 2011 nga po kjo komunë fiton dhe tenderin për mirëmbajtjen e rrugëve në vlerë prej 34 mijë eurosh.

Në vitin 2011 nga MI-ja, kompanitë “Shkoza F07 + Ndërtimi”, të dyja financuese të PDK-së, i kishte shpallur fitues të tenderit “Sanimi i rrugës Regjionale R105, segmenti: Klinë-Brojë, L=4.0km”, për të cilin është raportuar disa herë që është shoqëruar me shkelje, por ky vendim u anulua nga OSHP-ja.

Por, në vitin 2011 për “Shkoza FO7 ” u kujdes komuna e Vushtrisë, që udhëhiqte nga Bajram Maloku i PDK-së, e cila e angazhoi këtë kompani për mirëmbajtjen e rrugëve në dimër. Kjo informatë është dhënë nga Shtabi për Gatishmëri Emergjente i Vushtrisë, por nuk është publikuar vlera e kontratës mes komunës dhe kompanisë.

“Stublla” Shpk, pronë e Avni Stubllës, nga fshati Topliçan i komunës së Lipjanit, e që në vitin 2010 për PDK-në dha 9700 euro, nga MASHT ka marrë dy tenderë në vlerë prej 3.5 milionë eurosh.

“Stublla” kishte fituar të drejtën nga Komuna e Lipjanit për të ndërtuar me koncesion objektin për familjet e dëshmorëve, veteranët e luftës, familjet e martirëve dhe fëmijët bonjakë. Kjo kompani ishte shpallur fituese më 16 prill të vitit 2008 ndërsa Komunës i kishte ofruar 39.64 për qind të objektit.

Në një tender tjetër më 29 tetor 2010 kjo kompani ishte shpallur fituese për ndërtimin e objektit shkollor në fshatin Banullë të Lipjanit. Oferta e kësaj kompanie ishte 483 mijë e 684 euro.

E njëjta kompani kishte fituar në tenderin e datës 14 tetor të vitit 2009 në tenderin “Projektimi dhe zbatimi i rrjetit të kanalizimit –Livaxhe”. Në këtë tender ishte vetëm një ofertues ndërsa vlera e kontratës nuk ishte bërë publike në njoftimin për dhënie kontrate të publikuar në ueb-faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Kjo kompani ka bërë biznes, me mullirin e saj, edhe me kryetarin e komunës së Lipjanit, Shukri Buja, po ashtu i PDK-së. Sipas deklaramentit të pasurisë së Bujës, ky i fundit kishte deponuar grurin në mullirin e këtij kontraktori të Qeverisë, Komunës që ai udhëheq dhe njëherit financues i PDK-së. Hasan Preteni, Drejtor i AKK-së kishte thënë për “Zërin” se do të merret me këtë rast.

Kompania “Tali”, pronë e Florim Zukës, që për PDK-në në vitin 2009-2010 dha 11 mijë euro donacione, në MTPT për këto dy vite ka marrë 8 tenderë publikë, vlera e të cilëve arrin në 7.8 milionë euro.

Gjilani në vitin 2010, për “Talin” kishte dhënë 2 tenderë një në vlerë 400 mijë euro dhe një tjetër në vlerë prej 200 mijë eurosh, kurse në vitin 2011, e shpërbleu me 3 kontrata të tjera, një 74 mijë euro, një tjetër 59 mijë dhe të fundit 229 mijë euro.

Florim Zuka, pronar i “Talit” ka edhe tri kompani të tjera të regjistruara në Ministrinë e Tregtisë: “ETI Sh.p.k”., “ETii Roads Construction” SH.P.K. dhe NNT “Tali”.

“Timi Krško” Përfaqësia në Kosovë, që persona të autorizuar ka Sami Krasniqi-Drenoc Malishevë, Osman Krasniqi-Lupishtë Malishevë, e që për PDK-në dha në vitin 2009, 1 mijë euro, në MTPT ka marrë një tender prej 5.7 milionë eurosh. Edhe nga komuna e Malishevës, prej nga janë edhe dy përfaqësuesit e saj, i pati dhënë një tender prej 275 mijë eurosh.

N.T.,Alfa”, pronë e Ilir Begaj, e që për PDK-në në të dyja fushatat kishte dhënë 2500 euro nga MTPT-ja ka marrë një tender në vlerë prej 380 mijë eurosh. Në vitin 2011, nga komuna e Malishevës i ka dhënë dy tenderë në vlerë prej 150 mijë eurosh.

Sa dhe si përfituan bizneset e personave fizik që financuan fushatën e PDK-së?

-Bejtush Zhugolli, që për degën e PDK-së në Pejë në vitin 2009 dha 900 euro, ka në pronësi kompaninë “Pejton”. Vëllezërit e tij, me firmat e tyre kanë qenë pjesë e tenderëve publikë në këto tri vitet e fundit, 2008-2009-2010 vlera e të cilëve shkon në mbi 70 milionë euro. Korporata Energjetike dhe Operatori i Sistemit e Transmisionit të Energjisë Elektrike KOSTT kanë shpallur fitues kompaninë “Eco Trade”, pronë e Mehdi Zhugollit dhe atë “ACDC-KOS” të Ilmi Zhugollit në rreth dhjetë tenderë publikë, të cilët kanë

pasur të bënin me ndërrime të stabilimenteve, furnizime me pajisje e tenderë për riparim të shiritave transportues. Një pesë e madhe e këtyre tenderëve kanë qenë tender njëburimor, të kritikuar si tenderë me rrezikshmëri për favorizim nga ana e Komisionit Evropian.

Shaip Muja, ish-këshilltar i Kryeministrit Hashim Thaçi, që për PDK-në ka dhënë donacion 1 mijë euro ka 50% të aksioneve në "Ana Derm", kurse 50% të tjera i takojnë gruas së tij, Anita Muja. Ajo është edhe pronare në kompaninë tjetër private "Ana-Z", me anë të së cilës ka përfituar një kontratë nga fondet publike të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK), por që këta të fundit nuk pranojnë të bëjnë publike vlerën e saj.

Me anë të kësaj kontrate, kompania e gruas së deputetit të PDK-së, Shaip Muja, Anitës, "Ana-Z", ka realizuar një emision nga 1 maji 2011, "Estetika dhe shëndeti", i cili u transmetua së paku deri në dhjetor të këtij viti.

Edhe vëllai i deputetit Muja, Fatmir Muja nuk është lënë pa shpërblim nga njerëzit e PDK-së. Derisa me prokurimin e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) po udhëhiqte Njazi Thaçi, tash zëvendës drejtor i kësaj korporate dhe njëherit edhe kushëri i Kryeministrit Thaçi, kompania "CI-KOS" kishte fituar tenderin për shitjen e mbetjeve të metalit nga kjo korporatë. Kjo kompani tash është në pronësi të Fatmir Mujës, vëllai i deputet Shaip Muja dhe numri kontaktues i kësaj kompani është i njëjtë me kontaktin e kompanisë "Kosova Green Energy", biznes të cilin e kishte mbajtur fshehtë deputeti Muja.

Xhafer Zharku që për PDK-në kishte dhënë 650 euro ka në pronësi kompaninë N.T.Sh. " Shkëndia " Sh.p.k., e cila në vitin 2010 nga komuna e Kaçanikut, komunë e PDK-së, pati marrë tenderin: "Furnizim me naftë dhe derivate të naftës për nevojat e SHCK-së, Shëndetësinë, Shkollat dhe Zjarrfikësve", kontratë njëvjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një vit. Vlera e kësaj kontratë për vitin 2010 arriti në 150 mijë euro.

-Abdurrahim Kelmendi, që për PDK-në kishte dhënë 4 mijë euro donacion, ka në pronësi kompaninë " Solid Company " Sh.p.k. Kjo kompani është kontraktorë e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Zyrën e prokurimit të së cilës që nga vitit 2004 e deri në vitin 2011 e ka udhëhequr Njazi Thaçi, kushëri i Kryeministrit Hashim Thaçi.

Në vitin 2007, kjo kompani në KEK mori një tender prej 64 mijë eurosh, në vitin 2008 iu dhanë 5 kontrata prej afro 1 milion eurosh, në vitin 2009 1.4 milionë euro. Në vitin 2011, megjithëse një vit më herët "Colid Company" ishte penalizuar nga KEK për mos kryerje të punëve, iu dha edhe tenderi "FURNIZIM ME PJESE TE DERDHURA, PLLAKA DHE KONSTRUKCIONE TE ÇELIKTA.", vlera e të cili ishte 33 mijë euro.

Kjo kompani, në vitin 2006, ishte pjesë e një tenderi të kurditur. "Dosja me nr. të prokurimit 06/015/121 (Furnizim me dy Autoambulanca) gjaë verifikimit kemi hasur qe komisioni i vlerësimit te ofertave ka vlerësuar se tri oferta ("Nic Holding" , "Hyundai Auto Kosova" dhe " Solid Kompany") janë te përgjegjshme prej 7 sa kanë ofertuar, ndërsa prej tri te përgjegjshmeve "Nic Holding" dhe "Hyundai Auto Kosova" janë i te njëjtit pronar ku "Hyundai Auto Kosova" është e inkorporuar në kompaninë "Nic Holding" ("Nic Holding" ka ofertuar për dy autoambulancat me çmim 49.781€, ndërsa "Hyundai Auto Kosova" 55.500€), dhe fitues është zgjedhur O.E "Nic Holding" ku e ka nënshkruar kontratën me 24.11.2006 ne vlerë 49.781€", thuhet në raportin e ZAP për vitin 2006 për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Safet Sinani që dha për PDK-në 2 mijë euro ka në pronësi kompaninë N.N.P. " Ndërtimi ". Kjo kompani në vitin 2010 ka marrë nga komuna e Skenderajt tenderin "Mirëmbajtja e rrugëve të Qytetit dhe atyre rurale gjatë sezonit dimëror në Skenderaj" në vlerë prej 15 mijë eurosh, kurse në vitin 2011 mori tenderin "Furnizimi me zhavor për rehabilitimin e rrugës në lagjen "Hoti "në Leqinë", në vlerë prej 123 mijë eurosh.

Afrim Sylja që për PDK-në kishte dhënë 2 mijë euro ka në pronësi kompaninë N.T.SH. " DONI COMERCE ". Në vitin 2008-2009, sipas raportit financiar të komunës së Skenderajt, kjo kompani ishte kontraktorë për mirëmbajtje të ndërtesave dhe pajisjeve. Këto të dhëna janë shënuar në raport në pjesën e borxheve të komunës ndaj kontraktorëve, por nuk është gjendur ndonjë njoftim për dhënie të kontratës kësaj kompanie për këtë punë.

Për këtë kompani, komuna e Skenderajt në vitin 2008 shkeli ligjin mbi menaxhimin e financave publike. "Ne identifikua dy fatura te papaguara nga Doni Commerce me një total prej 17 mijë eurove, pjesë e zgjedhjes sonë, të cilat ishin leshuar ne vitin 2009, pas mbylljes se procedurave te prokurimit. Detyrimi ishte regjistruar qe gjate vitit 2008 kur ne fakt nuk duhej", thuhet në raportin e ZAP për vitin 2008 për Skenderaj.

Megjithkëtë, në vitin 2011, kjo komunë i dha kësaj kompanie edhe 5 kontrata në vlerë prej 400 mijë eurosh si dhe tenderin "Furnizimi me mjete nga elektrikë dhe mirëmbajtja e K.K, DKA-së , QKMF dhe QPS-se ne Skenderaj", që nuk ka pasur vlerë të përgjithshme të kontratës.

Hysni Shabani që për PDK-në kishte dhënë 1 mijë euro ka në pronësi kompaninë N.N.P. " HYSNIA ". Kjo kompani në vitin 2009 kishte marrë një tender prej 70 mijë eurosh nga MAPL-ja për ndërtimin e një shkolle në Vushtrri, nga komuna e Skenderajt në vitin 2010 morri 35 mijë euro në 5 tenderë të ndryshëm si dhe në vitin 2011, po nga kjo komunë e PDK-së mori edhe tenderin "Rregullimi i bankinës përgjatë lumit Silnica në fsh. Pestovë", në vlerë prej 8 mijë eurosh.

Selvije Deda që për PDK-në kishte dhënë 1 mijë euro donacion ka në pronësi kompaninë N.N.T.,Eurotrans". Kjo kompani në tri vite, 2009-2011, në komunën e Kaçanikut ka marrë mbi 520 mijë euro tenderë publikë. Në vitin 2010 kishte marrë 179 mijë euro, kurse në vitin 2011 mori një tender prej 89 mijë eurosh në Fushë Kosovë.

Ilmi Azemi, që për PDK-në dha si donacion 800 euro ka në pronësi kompaninë " Korabi -Company " Sh.p.k. Kjo kompani në Vushtrri në vitin 2011 ka marrë tri kontrata publike në vlerë prej 40 mijë eurosh.

Musa Cakaj. Nga Stanofci i Epërm Vushtrri, e që për PDK-në dha 300 euro donacion, në pronësi ka kompaninë N.T.SH. Autogarazha " Euro Color". Ky person, nga Komuna e Vushtrrisë në vitin 2010 i është dhënë me koncesion një pronë komunale (në procesverbal nuk përmendet sipërfaqja që ai përfitoi nga komuna). gjatë kësaj pike të rendit të ditës, nuk kanë marrë pjesë as në shqyrtim dhe as në votim grupi asambleistë i AAK-së dhe ai i LDK-së, duke e lëshuar sallën ku mbahej seanca e Kuvendit.

Mustafë Shala që për PDK-në ka dhënë mbi 5500 euro ka në pronësi, pos tjerash edhe kompaninë " Compact Group " Sh.p.k., si dhe është ortak me Kryetarin e Gjilanit, Qemajl Mustafa në fabrikën për pjekjen e bananeve "Viva Fruta".

Kjo kompani tradicionalisht është kontraktore e komunës së Gjilanit. Që në raportin e auditimit për vitin 2007, 2008, 2009 tek pjesa e borxheve që komuna i ka kontraktorëve, emri i "Compact Group" është shënuar në disa furnizime e shërbime. Në këto lista, të kompanive që kanë kryer shërbime për komunën e Gjilanit, është renditur tradicionalisht, që kur është kryetar i Gjilanit Qemajl Mustafa edhe "Hotel Kristal", po ashtu pronë e Mustafë Shalës.

Në vitin 2008, komuna e Gjilani shkel edhe ligjin mbi financat publike për "Compact Group" dhe disa kompani të tjera. "Gjatë testimit tonë ne kemi identifikuar disa raste kur pagesat për fatura janë bërë më vonë se brenda 30 ditëve nga data e faturuar. Rastet e identifikuara kanë të bëjnë me furnitorët siç janë: NTP Metali, Saraj, NT Pylla, Bio Lab, Compact Group, etj. Ndikimi mund të ketë risk pasi që entiteti nuk është në përputhje me instruksionet administrative përkatëse që të përmbush të gjitha obligimet e saj brenda 30 ditëve", thuhet në raportin e ZAP për vitin 2008, ku kjo shkelje kualifikohet me: "Rreziku i ulët".

Në vitin 2011, "Compact Group" u shpërblye me 10 tenderë prej Komunës së Gjilanit, vlera e të cilëve së bashku arrinë në mbi 270 mijë euro. Në po këtë vit, komuna e Gjilanit miraton edhe shkëmbimin e pronës në mes të Hotel "Kristalit" të Mustafë Shalës dhe komunës. Shala do t'i jap komunës një pronë prej 479 metra katrorë, sipas opozitës së kësaj komune shumë më pak e vlefshme se sa një parcelë prej 433 metra katrorë para këtij hoteli dhe buzë rrugës kryesore të qytetit, të cilën e përfitoi në ndërrim me komunën.

Kjo kompani ka marrë miliona euro tenderë publik edhe nga Kompania Publike "Termokos". Për dy sezone, 2009-2010, 2011-2012 "Compact Group" ishte kontraktuar nga "Termokos" për furnizim me mazut, shpenzimet e të cilit për një sezon sillen nga 5-7 milionë euro. Po për këtë kompani, "Termokos" kishte shkelur ligjin.

ZAP në vitin 2010 ka gjetur se "Termokos" ishte furnizuar me mazut në sasi prej 7511 tonë, ndërsa ishin shpenzuar gjithsej 7500 ton. Sipas rishikimit të kontratës që e kanë bërë auditorët, të nënshkruar më 30.09.2010, kanë vërejtur se çmimi i ofruar në ofertë ishte çmimi sipas bursës plus premia 17.68€ për ton, kurse kontrata dhe pagesat për mazut ishin bërë sipas çmimit prej 26 euro plus premi për ton.

Edhe në vitin 2009, në po të njëjtin tender dhe me po të njëjtën kompani, auditorët gjetën shkelje të shumta. ZAP-i në 2009 gjeti se "Compact Group" ka furnizuar me mazut "Termokos"-in me çmimin për ton më të lartë sesa kompanitë tjera që kanë importuar mazut në Kosovë, ku ishte shkaktuar një dëm në vlerë prej 307.497€. Ky institucion i pavarur pati gjetur edhe se përfaqësuesi i "Compact Group" nuk ka pasur as licencën e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për furnizim me mazut dhe derivate të naftës, siç është kërkuar me dosje të tenderit.

Për më shumë, në vitin 2010 kur "Compact Group" mori edhe një herë tenderin e mazutit procedura për zgjedhjen e kompanisë ishte anuluar dy herë.

- **Petrit Jerliu**, që është person i autorizuar në kompaninë K.N.T.SH. " Teuta - M " Sh.p.k., e që për PDK-në ka dhënë 2 mijë euro donacion në vitin 2007 ka marrë nga komuna e Gjilanit në vitin 2004, 170 mijë euro, në vitin 2006 edhe 150 mijë euro të tjera, në vitin 2007, në konzorcium me kompaninë "Akuadrila" mori edhe 316 mijë euro si dhe në vitin 2008 edhe 120 mijë euro të tjera tenderë publikë.

Në vitin 2010 kjo kompani mori nga Gjilani edhe tri kontrata publike në vlerë prej 400 mijë eurosh, si dhe në vitin që lamë pas edhe 2 kontrata të tjera në vlerë prej 110 mijë eurosh.

Hajrush Misnini që për PDK-në dha 1 mijë euro ka në pronësi kompaninë NNSH,,Hajrush". Kjo kompani në vitin 2009 kishte marrë një tender nga komuna e Vitisë në vlerë prej 138 mijë eurosh dhe një tjetër tender prej 25 mijë eurosh nga komuna tjetër e PDK-së, ajo e Gjilanit.

Në vitin 2010, kjo kompani përfitoi edhe një tender prej 58 mijë eurosh nga komuna e Vitisë për "ndërtimin e kanalit të hapur dhe rrugëve në rrugën,, Kongresi i Manastirit", por për të cilin komuna e PDK-së, e shkeli ligjin mbi financat publike. "Gjatë auditimit tonë ne kemi vërejtur se pagesat e bëra për furnizuesin "N.N.SH Hajrush" nuk kanë qenë në përputhje me kontratën e nënshkruar ndërmjet furnizuesit dhe Komunës. Sipas kontratës ndërmjet Komunës dhe furnizuesit për projektin "Ndërtimi i kanalit të hapur dhe rrugës në rrugën "Kongresi i Manastirit", pagesat për furnizuesin duhet të bëhen në tri këste, 20% dhe 30% pas përfundimit të pjesshëm të punëve dhe 50% pas përfundimit të plotë të punëve nga kontraktuesi. Ne kemi vërejtur se kësti i parë që i është paguar furnizuesit ka qenë 50% e vlerës së kontratës, kësti i dytë që i është paguar furnizuesit ka qenë 35% e vlerës së kontratës dhe kësti i fundit që i është paguar furnizuesit ka qenë 15% e vlerës së kontratës. Ndikimi: "Ekziston rreziku që mjetet e Komunës janë keqpërdorur gjatë këtij procesi", thuhet në raportin e ZAP për Vitinë në vitin 2010, që këtë gjetje e kualifikojnë: Rreziku i lartë.

Shpend Musa që për PDK-në dha 2 mijë euro, ka në pronësi kompaninë N.P.N. " Vision Project ". Kjo kompani, sipas gjetjeve të "Preportr", ishte zgjedhur fituese në një tender prej 25 mijë eurosh nga komuna e Pejës, që udhëhiqet Ali Berisha nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), por që tenderi është anuluar pasi që OSHP-ja gjeti shkelje.

Ky biznesmen ka në pronësi edhe kompaninë N.T.SH. " Cipa Protech ", më të cilën në vitin 2008 i shiti kompjuterë në vlerë prej 31 mijë eurosh komunës së Gjilanit, komunë e PDK-së. Nga kjo komunë në vitin 2011 ka marrë edhe një tender prej 13 mijë eurosh, kurse në këtë vit, po nga kjo komunë, fitoi tenderin "Furnizim me tonerë për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë", në vlerë prej 9 mijë eurosh.

-**Mehmet Ismaili** nga Prelezi i Jerlive Ferizaj që për PDK-në dha 1 mijë euro ka në pronësi kompaninë " Mermer Commerc 1 " Sh.p.k. Kjo kompani, që nga qershori i vitit 2008 është pajisur me leje për eksplorim, që i skadon në vitin 2013 dha leje për eksploitim, që i skadon në nëntor të vitit 2021. Vendet në të cilat i është dhënë licenca për të punuar nga KPMM-ja janë Reçaku dhe "Lugu i Shtogut", në zonën e fshatit Belinc.

Për PDK-në janë derdhur edhe 500 euro donacion, të cilat janë ruajtur me nr. të biznesit: **70558556**. Me këtë nr. të regjistrimit është e regjistruar kompania N.N. " MEB - ING ", pronë e Ekrem Kryeziut nga Fushë- Kosova. Kjo kompani në vitin 2011, në konzorcium me kompaninë N.N.P."PRO TEK" mori tenderin: " NDËRTIMI I QMF-së NË RATKOC" në vlerë prej 126 mijë eurosh.

Për PDK-në ishin derdhur 500 euro si donacion nga një biznesmen që la vetëm nr. e biznesit: **70061364**. Me këtë nr. të biznesit gjendet kompania NPT,,Beli", pronë e Blerim Zulfaj nga fshati Senik i Malishevës. Kjo kompani në vitin 2010 nga komuna e Rahovecit mori 130 mijë euro. Që nga viti 2007-2008, pastaj edhe në vitin 2011 kjo kompani ishte e angazhuar nga komuna e Malishevës për "TRANSPORTI I NXËNËSVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA". Po nga kjo komunë, në vitin 2011, mori edhe kontratën "TRANSPORTI I PACIENTËVE ME HEMODIALIZË MALISHEVË – PRIZREN", nga e cila fiton 235 euro për çdo ditë.

Për PDK-në ishin dhënë donacion 500 euro nga një biznes me numrin: **80266375**. Në regjistrat e Ministrisë së Tregtisë del që është kompania N.N.P. " Arbëri -NS ", pronë e Naim Selmanit.

Ky financues i PDK-së mori nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) mori tenderin "Ndërtimi i objektit të Gjykatave në Malishevë", që peshon 395 mijë euro. Po në këtë vit, në konzorcium me kompaninë "Dijamanti" mori nga komuna e Prizrenit, komunë e PDK-së, një tender prej 27 mijë eurosh për "Ndërtimin e objektit te zyrës civile ne fshatin Velezhë te Prizrenit".

Në vitin 2011, nga komuna e Malishevës mori tenderin "NDËRTIMI I SHKOLLËS „HILMI HOTI" NË FSHATIN CARRALLUKË" tender që peshon 457 mijë euro, si dhe nga komuna e Shtimjes, po ashtu komunë e PDK-së, mori tenderin "RREGULLIMI I SHTRATIT TE LUMIT NË SHTIME", që peshon 234 mijë euro.

Për PDK-në , nga biznesi me nr : **80673906**, e që del të jetë kompania N.P.T. "Adessa", pronë e Manush Destanit, dhe për preson të autorizuar ka Jemin Destanin, janë dhënë 3 mijë euro donacion. Ky biznes në vitin 2010 nga komuna e Prizrenit mori dy tenderë, që së bashku peshojnë 57 mijë euro, si dhe një tender në vitin 2011, po nga kjo komunë e PDK-së, që peshon 19 mijë euro.

150 euro ishin dhënë donacion për PDK-në nga biznesi me numër të regjistrimit : **80406568**, e që del të jetë kompania N.N.T."Riza A.M", pronë e Ilir Hasanit, e regjistruar për herë të fundit në vitin 2003.

Megjithëse dha veç 150 euro, sipas raporti të kontratave publike të komunës së Prizrenit për vitin 2008, kjo kompani u shpërblye këtë vit me 2 kontrata, që së bashku peshojnë 35 mijë euro. Sipas të njejtit dokument për vitin 2009, kjo kompani nga Prizreni mori dhe 7 kontrata publike që bashkë peshojnë 272 mijë euro. Me tri kontrata të ndryshme, po nga komuna e Prizrenit, kjo kompani u shpërblye edhe në vitin 2010, që të gjitha së bashku peshojnë afro 150 mijë euro. Në vitin 2011, N.N.T."Riza A.M" përsëri shpërblehet nga Komuna e Prizrenit me 2 kontrata, që së bashku peshojnë 38 mijë euro.